

VENDIM
Nr.1550, datë 26.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të institucioneve në varësi të saj, bashkisë Durrës, t’i përfundojnë deri më 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit për ndërtime, mallra e shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe publikimi i fituesit dhe publikimi i njoftimit të kontratës së lidhur në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI I PROJEKTVENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË KRYERA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE INSTITUCIONET E VARËSISË SË SAJ

Nr	Emërtimi i projektit	Vlera limit në lekë	Financimi i vitit 2008 në lekë
I	APARATI I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS		
1	Blerje e mjeteve didaktike Arsimit bazë dhe i mesëm	306,433,267	306,433,267
2	Rikonstruksioi i rrjetit elektrik të Godinës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës	10,795,260	7.950,000
II	UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS		
3	Pajisje Mobileri për Fakultetin e studimeve të Integruara me Praktikën Universiteti Durrës	3.333.600	3.333.600
4	Pajisje Elektronike për Fakultetin e studimeve të Integruara me Praktikën Universiteti Durrës	8.181.000	8.181.000
	Akademia e sporteve “Vojo Kushi” Tiranë		
5	Ndërtimi i sallës së leksioneve dhe konferencave Akademia Sporteve Tiranë	10,000,000	10,000,000

6	Mirëmbajtje ndërtese Akademia e Sporteve Tiranë	2.000.000	2.000.000
	DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE DURRËS		
7	Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Beqir Çela” Durrës	18,000,000	5.500,000
	Drejtoria arsimore qyteti Tiranë		
8	Rikonstruksioni i shkollës së emsme të Gjuhëve të Huaja Tiranë	65,000,000	5.000.000
III	BASHKIA DURRËS		
9	Ndërtimi i Konviktit pranë konviktit beqir Çela Durrës	50.000.000	15.000.000
	Totali	473.743.127	363.397.867